

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-91/11

Prishtinë 1 mars 2012

Në çështjen e:

S.D.

Pala ankuese

Kundër

S.N.

Paraqitësi i kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Anne Kerber, Kryetare e kolegjit, Elka Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, gjyqtarë, në lidhje me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/83/2010 (lënda është e regjistruar në AKP me numrin KPA20030), të datës 2 shtator 2010, pas shqyrtimit të mbajtur me 1 mars 2012, mori këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Refuzohet si e palejueshme ankesa e S.D..
- 2- Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/83/2010, i datës 2 shtator 2010, për aq sa ka të bëjë me lëndën e regjistruar me numrin KPA20030.
- 3- Obligohet pala ankuese që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej € 42,50 (dyzetedy euro e pesëdhjetë cent) brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Me 16 nëntor 2006, S.N. ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) ku kërkonte që të njihet si (bashkë)pronar i disa ngastrave të ndryshme të tokës të përvetësuar si dhuratë nga nëna e tij dhe ka kërkuar ri-posedimin e tyre. Ai ka sqaruar se ngastrat e regjistruara në fletën poseduese nr. 21 të Komunës së Podujevës i përkisnin nënës së tij, P.N., dhe se ajo ia kishte dhënë ato atij dhe vëllait të tij si dhuratë në vitin 1984. Paraqitësi i kërkesës ka deklaruar se toka i ishte dhënë me qira Kooperativës Bujqësore “JEDINSTVO” në Podujevë dhe se prona ishte humbur me 12 qershor 1999 si rezultat i rrethanave në Kosovë në vitin 1998/1999.

AKP-ja e ka ndarë kërkesën origjinale në disa kërkesa. Pas ndarjes, dosja origjinale e AKP-së nr. KPA20030 përmbante vetëm ngastrat me numrat 351 dhe 352.

Për të mbështetur kërkesën e tij, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur në AKP marrëveshjen mbi dhurimin të nënshkruar me 27 qershor 1984 nga P.N. si dhuruese dhe paraqitësi i kërkesës e Z.N. si pranues të dhuratës. Marrëveshja ishte vërtetuar në Gjykatën Komunale në Podujevë dhe ishte regjistruar si O.br. 586/84. Sipas kësaj kontrate, paraqitësit të kërkesës dhe vëllait të tij iu është dhënë prona e regjistruar në fletën poseduese nr. 21 në zonën kadastrale të Llapashticës së Epërme.

Marrëveshja mbi dhurimin wshtw verifikuar nga AKP-ja.

AKP-ja po ashtu ka gjetur fletën poseduese nr. 21 të lëshuar nga Kombet e bashkuara me 2 tetor 2008 për Komunën e Podujevës, zona kadastrale e Llapashticës së Eperme. Kjo fletë ka treguar ndër të tjera se P.N. ishte pronare e dy ngastrave në “Lagjen e Berqanve – Fshati”, ngastra nr. 351, livadh i klasës 6 me sipërfaqe prej 2 ari e 80 m², dhe ngastra nr. 352, arë e klasës 6 me sipërfaqe prej 22 ari e 27 m².

Me 18 maj 2009, ekipi për njoftimi i AKP-së ka shkuar në vendet ku pretendohet se ndodheshin ngastrat e kërkuara dhe ka vendosur shenjat që tregojnë se prona ishte subjekt i kërkesës dhe se palët e interesuara do të duhej të paraqitnin përgjigjet e tyre brenda 30 ditëve. Prona (lëndinë dhe arë e kultivuar) është gjetur e uzurpuar. Prandaj, ekipi për njoftim ishte përpjekur që të identifikojë personin që ishte në shfrytëzim të pronës por pa sukses. Disa banorë vendas nuk e dinin se kush e kishte uzurpuar pronën, ndërsa të tjerët nuk dëshironin të tregonin për personin. Me 12 prill 2010, ekipi për njoftim ka shkuar përsëri në atë vend dhe e ka përsëritur njoftimin, duke vendosur një pllakatë në secilën ngastër. Këtë herë, e tërë prona është gjetur e kultivuar dhe fotografitë kanë treguar se ajo ishte lëruar. Ekipi për njoftim përsëri është mundura që të identifikojë uzurpatorin por nuk ka qenë në gjendje ta bëjë këtë. Me vonë gjatë procedurës, njoftimi është kontrolluar nëpërmjet GPS-it dhe ortofotografive dhe është konfirmuar si i saktë.

Pasi që askush nuk ka reaguuar ndaj njoftimit, kërkesa është trajtuar si e pakontestuar. AKP-ja nuk e ka pasur të vështirë të gjej se P. dhe P.N. ishin i njëjti person pasi që letërnjoftimi i paraqitësit të kërkesës ka treguar se babai i paraqitësit të kërkesës quhej R. dhe fleta poseduese ka treguar se R. ishte bashkëshorti i “P.”.

Me 2 shtator 2010, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) me vendimin e vet KPCC/D/A/83/2010 ka gjetur se paraqitësi i kërkesës kishte vërtetuar pronësinë mbi pronën e kërkuar ose të asaj pjese siç specifikohet në vendimet përkatëse individuale. Komisioni ka urdhëruar që paraqitësit të kërkesës t’i jepet posedimi i pronës së kërkuar dhe se çdo person që ka uzurpuar pronën ta lirojë atë brenda 30 ditëve nga dorëzimi i urdhëresës, ose përndryshe do të dëbohen..

Vendimi i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës me 12 mars 2011. Me 4 maj 2011, paraqitësi i kërkesës ka kërkuar ri-posedimin e pronës.

Me 6 ose 7 korrik 2011, S.D., ka dhënë një deklaratë në AKP. Ai ka deklaruar se e kishte takuar një person me vendimin e KKPK-së me 5 korrik në vendin e tij. Vetëm atëherë ai kishte qenë në dijeni se prona ishte e kontestueshme. Ai ka deklaruar se ngastrat kishin qenë në posedim të familjes së tij për 50 deri 60 vite dhe ai

e kishte konsideruar atë të jetë pronë e babait të tij të ndjerë H.D. i cili ishte vrarë në vitin 1988 së bashku me gjashtë anëtarë tjerë të familjes së afërm. Për më tepër, ai ka thënë se dokumentacioni lidhur me pronën ishte djegur gjatë luftës. Ai kishte kërkuar një takim urgjente me Kryesuesin e AKP-së.

Në mbështetje të deklaratës së tij, S.D. (me tutje në tekst “pala ankuese”) ia paraqiti AKP-së me 1 gusht 2011 deklaratë e vëllezërve dhe motrave të tij, E.D., S.D., A.D., H.D.M., F.D.Z. dhe G.D.S.. Të gjithë kanë konfirmuar deklaratën e D. se ngastrat i përkisnin babait të tyre të ndjerë, se kanë ekzistuar kontrata e shitblerjes të cilat janë djegur gjatë konfliktit në Kosovë dhe se ngastrat ishin kultivuar nga familja që nga 50 deri në 60 vite..

AKP-ja e ka interpretuar deklaratën si një ankesë dhe atë ia ka dorëzuar paraqitësit të kërkesës (me tutje në tekst “pala përgjegjëse në ankesë”) me 22 shtator 2011. Pala përgjegjëse në ankesë nuk ka reaguar.

Arsyetim ligjor:

Siç çështje paraprake, Gjykata Supreme vëren se pala ankuese nuk ka dhënë ndonjë hollësi lidhur me adresën përveç numrit të tij të telefonit.

Gjykata Supreme është e pajtimit me AKP-në se deklarata duhet të interpretohet si ankesë kundër vendimit të KKPK-së KPCC/D/A/83/2010. Është e qartë se pala ankuese dëshiron që të kundërshtojë këtë vendim, madje edhe nëse ai nuk kërkon shprehimisht që ai të prishte. Për më tepër dosja e lëndës përmban një e-mail të datës 12 korrik 2011, me anë të së cilës një anëtar i AKP-së kërkon nga një tjetër anëtar që ta kontaktoj palën ankuese dhe ta njoftojë se nuk kishte nevojë për të mbajtur një takim me menaxhmentin, dhe në vend të kësaj kërkesa e tij do të dërgohej si ankesë në Gjykatën Supreme dhe se në rast se posedonte ndonjë dokument ai duhej t'i dorëzonte ato brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh. Pasi që pala ankuese me të vërtetë kishte dorëzuar deklaratat me shkrim me 1 gusht 2011, gjykata vjen në përfundim se pala ankuese ishte njoftuar për pasojat ligjore të deklaratës së tij dhe se ai ishte i gatshëm që të paraqiste që të paraqiste ankesën.

Megjithatë, ankesa është e palejueshme.

Sipas nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 për zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, pala mund të paraqes ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i vendimit. Po ashtu, neni

176.1 dhe 177.1 i Ligjit Nr. 03/L-006 mbi Procedurën Kontestimore parasheh se e drejta për të paraqitur ankesë i përket palëve në procedurën e shkallës së parë.

Në rastin në fjalë, pala ankuese nuk ka qenë palë në procedurën e shkallës së parë para KKPT-së. Për të sqaruar një situatë të tillë, pala ankuese ka pohuar se ai ishte vënë në dijeni të kontestit lidhur me ngastrat vetëm me 5 korrik 2011, që i bie pas vendimit të KKPK-së të datës 2 shtator 2010. Në të vërtetë, në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079: “Personi që ka interes ligjor në kërkesë i cili nuk ka pranuar njoftimin e kërkesës mund të pranohet si palë në çdo kohë gjatë procedurës.”

Prandaj, Gjykata Supreme duhet të kontrollojë nëse S.D. ishte njoftuar me kërkesën. Mënyra për njoftimin e kërkesës në këtë proces të veçantë të kërkesave masive parashihet me nenin 10.1 të rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079. Sipas kësaj dispozite, Sekretaria Ekzekutive duhet ta njoftojë me kërkesën çdo person i cili aktualisht shfrytëzon apo pretendon të ketë të drejta ndaj pronës ose ajo duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme për të njoftuar me kërkesën çdo person që mund të ketë interes ligjor në pronën në fjalë.

Në rastin konkret, operatori i AKP-së ka vërejtur se prona ishte e uzurpuar, por ekipi për njoftim nuk ka arritur që të siguroj emrin e uzurpatorit. Prandaj, Sekretaria Ekzekutive ka vazhduar me njoftimin duke vendosur një pllakatë në secilën ngastër me datën 12 prill 2010. Kjo masë paraqet përpjekje të arsyeshme për njoftim të duhur të kërkesës. Për më tepër., asgjë nuk tregon se S.D. nuk ka mundur të vihej në dijeni të njoftimit. Ai jeton në fshatin ku ndodhen ngastrat (në deklaratën e tij ai thotë se e kishte takuar në vendin e tij personin me vendimin e KKPK-së) he pllakatet nuk ishin vendosur në një vend që nuk ishte vizituar asnjëherë, për shembull vetëm në shkurre, por në një vend që ishte i kultivuar. Pasi që afati kohor për të paraqitur mbrojtjen ndaj kërkesë është 30 ditë, S.D. kishte mundësi që të përgjigjej në kërkesë deri me 12 maj 2010.

Nga të gjitha elementet e përmendura më lartë, Gjykata Supreme konsideron se pala ankuese kishte mundësi që të njoftohej rreth procedurës dhe të paraqiste mbrojtjen e tij në nivel në shkallë të parë. Pasi që ai nuk është përgjigjur në kërkesë dhe pasi që nuk ka qenë palë pra KKPK-së, atij nuk i lejohet më që të paraqitet para Gjykatës Supreme për të paraqitur ankesë. Në këtë mënyrë, ankesa e tij hedhet poshtë si e palejueshme në pajtim me nenin 13.3 (b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 (shih gjithashtu nenin 196 and 195.1 (a) të Ligjit mbi procedurën Kontestimore).

Shpenzimet e procedurës:

Në bazë të Shtojcës III, nenit 8.4 të Urdhërësës Administrativ (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, regjimi normal i pagesës së taksës gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, tarifat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit::

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (nenet 10.21, 10.15 dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pasur parasysh se vlera e pronës së kërkuar më arsye mund të vlerësohet në € 3.000: € 12,50.

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga ankuesi që humb rastin. Në përputhje me nenin 45.1 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë është 15 ditë. Neni 47.3 parasheh që në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së gjobës. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë juridike

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Elka Ermenova, Gjyqtare e EULEX-it

Urs Nufer, Rexhistrues i EULEX-it